



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 16.01.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Glauk Konjufca, Agim Aliu dhe Igor Simiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Edita Kusari, EUSR/EUO; Shaban Murturi, EUSR/EUO; Sanije Berisha, OSBE ; Labinot Leposhitica, BIRN; Donika Osmani, Ekonomia Online; Albulena Nuha, RTV21; Shefki Kastrati, NDI; Gëzim Shala, IKD/BPD dhe Albulena Ukimeraj, OAK.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.11.2017;
3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-019 për Standardizim;
6. Zëvendësimi i anëtarit në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
7. Caktimi i dëgjimeve publike për Projektligjet nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore;
8. Të ndryshme.

**Kryetarja** njoftoi anëtarët e komisionit rreth raportit me amendamente për projektligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ku tha se Komisioni për Buxhet ka kërkuar të futet në rend dite me arsyetimin si kërkesë urgjente sepse është kusht që Qeveria e Kosovës të përfitojë një grand nga Qeveria Suedeze për zbatimin e reformës së re në tatimin në pronën e paluajtshme. Kryetarja propozoi që ky raport të futet si pikë e rendit të ditës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen rreth këtij propozimi.

*Meqë nuk kishte diskutime anëtarët e komisionit vendosen që ky propozim të shtyhet për mbledhjen e radhës.*

**Hajdar Beqa** propozoi që si pikë e rendit të ditës të futet edhe diskutimi rreth punëtorisë dhe planit të veprimit për Rregulloren e Kuvendit.

*Anëtarët e komisionit u pajtuan që ky propozim të futet si pikë e 8 (tetë) të rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.11.2017**

**Kryetarja** konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin, nga mbledhja e mbajtur më 14.11.2017, pa vërejtje.

### **3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2017**

**Kryetarja** konstatoi se komisioni në mënyrë unanime miratoi Raportin e Punës së komisionit për vitin 2018.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës**

**Kryetarja**-Tha se ka vërejtje në nenin ku flitet për benifitet që i gëzon Presidenti pas mandatit. Kur dihet gjendja sociale në të cilën jetojnë qytetarët e vendit tonë, ajo tha se ka kundërshtuar dhe vazhdon të jetë kundër këtyre privilegjeve.

**Arben Gashi**-Tha se përderisa nuk ka një ligj i cili rregullon në tërësi hierarkinë e ish -zyrtarëve të lartë shtetëror të cilët mund të kenë përfitime nga sistemi për një periudhë të caktuar kohore, ky ligj duhet të përkrahët ashtu si është.

**Korab Sejdiu**- Tha se shpreh shqetësim për përfitime të shumta që kanë ish -zyrtarët e shtetit duke pasur parasysh buxhetin modest që ka Kosova, por deputeti Sejdiu shtoi duke thënë se, përderisa ka ish- funksionarë me funksione shumë më të ulëta shtetërore të cilët kanë përfitime të shumta, mendoj se është e padrejtë që t'i mohohet e drejta presidentit të gëzojë privilegje edhe pas mandatit.

**Sami Kurteshi**-Tha se problemi nuk qëndron te privilegjet, por problemi është te mospërputhja, diskriminimi ligjor, mos-proporcionaliteti dhe mos marrja parasysh e drejtësisë sociale në vendin tonë, prandaj kundërshtojë në parim formë e ndryshimit të ligjit, theksoi deputeti Sami Kurteshi.

**Hajdar Beqa:** Meqenëse flitet për kreun e shtetit është mirë që ky ligj të procedohet për seancë plenare ashtu si është.

*Pas diskutimeve, kryetarja Konstatoi se me 6 (gjashtë) vota për dhe 2 (dy) kundër vendosi që Kuvendit dhe komisioneve kryesore t'ua paraqesë këtë:*

## **R a p o r t**

### **Për Projektligjin nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës**

Të shqyrtohet dhe miratohet Projektligji nr. 06/L-004, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës, pa amendamente.

#### **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-019 për Standardizim**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-019 për Standardizim ku tha se janë nëntëmbëdhjetë amendamente me vetëm një vërejtje në amendamentin nëntëmbëdhjetë, ajo kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje të tjera.

*Meqë nuk kishte vërejtje të tjera kryetarja konstatoi se me vërejtjen e paraqitur, komisioni në mënyrë unanime vendosi që Komisionit Funkcional t'ia paraqesë këtë:*

#### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 06/L-019 për Standardizim dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **6. Zëvendësimi i anëtarit në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**

**Kryetarja**- Tha se në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 23, nënparagrafi 1.3 të Ligjit 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit, në vend të deputetit Nezir Çoçaj, i cili

ishite anëtar i këtij komisioni, propozohet deputeti Sami Kurteshi. Deputetja Haxhiu kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse pajtohen ose kanë ndonjë propozim tjetër.

*Meqë kishte pajtueshmëri dhe nuk kishte diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:*

## **V e n d i m**

Për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Z. Sami Kurteshi, deputet dhe anëtar i Komisionit për Legjislacion, emërohet anëtar në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në vend të deputetit Nezir Çoçaj.

### **7. Caktimi i dëgjimeve publike për Projektligjet nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jo-kontestimore**

Komisioni vendosi që dëgjimi publik për: Projektligjin nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, Projektligjin nr. 06/L-010 për Noterinë dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore, të mbahet më 24.01.2018 në orën 11:00.

### **8. Diskutim në lidhje me punëtorinë për Rregulloren e Kuvendit**

**Hajdar Beqa**, në cilësinë e kryesuesit të Grupit Punues për Rregulloren e Kuvendit, paraqiti para anëtarëve të komisionit planin e veprimit dhe gjithashtu punën që është bërë nga Grupi Punues në bashkëpunim me administratën e Kuvendit në punëtorinë që është mbajtur në Tiranë më 26-28 dhjetor. Beqa tha se ky draft do t'iu dërgohet sot Grupeve Parlamentare në mënyrë që të paraqesin kërkesat dhe vërejtjet e tyre në lidhje me draftin që më pas, sipas afatit kohor, të përcaktuar në planin e veprimit, vërejtjet apo kërkesat nga grupet parlamentare t'i harmonizojmë në mënyrë që drafti të procedohet për miratim në komision.

### **9. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

\_\_\_\_\_  
**Albulena Haxhiu**